



**REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE
DRAGASH - DRAGAŠ
ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU**

Zyra per prokurim ne Dragash, ne baze te kerkeses per rishqyrtim te bere me date 01.04.2021 nga OE “ PUNA ” -Prizren , ne lidhje me aktivitetin e Prokurimit me nr: 621-20-3171-521” Ndertimi I objektit te qendres se Mjeksise familjare ne fshatin Krusheve(projekt dy vjeqar), dhe duke u bazuar ne Rregullat qe adoptojne,plotesojne dhe japin sqarime per paraqitje te kerkeses per rishqyrtim prane Autoriteteve Kontraktuese,parashtrim te ankesave prane OSHP-se dhe vlera e tarifave te ankesave si dhe duke u bazuar ne nenin 8.1.1 te kesaj rregulloreje-te aprovuara nga Komisioni Rregullativ I Prokurimit Publik I cili ne pajtim me Nenin 87,parografi 2,nen paragafin 2.8 dhe nenin 118,parografi 1,te Ligjt mbi prokurimin Publik nr.04/L-042,I ndryshuar dhe plotesuar me ligjin nr.04/L-237,ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin nr.05/L-092,dhe nenit 39.8 te RRUOPP-it bjen kete :

V E N D I M

- 1. Refuzohet kerkesa e OE “ PUNA ” Sh.p.k-Prizren e propozuar per rishqyrtim si e pa baze,**
- 2. Nuk nevoitet informacion shtese per kete aktivitet, pasi qe e njejtë eshte bere me pare dhe lenda konsiderohet e gjykuar.**

A R S Y E T I M

Lidhur me kerkesen tuaj per rishqyrtim te vendimit te Autoriteti Kontraktues ne lidhje me tenderin “ Ndertimi I objektit te qendres se Mjeksise familjare ne fshatin Krusheve(projekt dy vjeqar, dhe duke u mbeshtetur ne nenin 39.8 te RRUOPP-it)konstatojme se kerkesa eshte e pa bazuar dhe nuk kerkohet kurrfare informacioni shtese.

Ne pozicionin KALDAJA-NENSTACIONI

Pozicioni 3.1.12 nuk është plotësuar pozicioni për qmimin njësi (mungon çmimi)

Sipas udhezuesit Operativ nen 39.8 (Si te veprohet



**REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE
DRAGASH - DRAGAŠ
ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU**

Mungon çmimi Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Kusht administrativ

Duke u bazuar edhe ne bazë të pyetjeve të shpeshta te cilat gjenden ne Web faqen e KRPP-se:

29. Cila është procedura që duhet ndjekur në rast se Operatori Ekonomik vendos çmimin “0.00” euro në një nga artikujt/pozicionet (elementet përbërëse të tenderit)? (Referoju RRUOPP)

KRPP Një procedurë e tillë nuk është e rregulluar me dispozita të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj, megjithatë autoritetet kontraktuese duhet të veprojnë si në vijim:

Nëse Operatori Ekonomik nuk plotëson një nga pozicionet(çmimi per njesi) në Listën e Përshkrimit të Çmimeve, tenderi duhet të refuzohet, pasi që tenderi gjithmonë duhet të jetë në përpunhje me qëllimin e plotë të kontratës.

Prandaj mosplotesimi i një pozicioni ne paramase askund ne Ligj nuk parashihet si gabim aritmetik siq e keni theksuar ju ne sqarimin tuaj dhe nuk ka te beje fare me +,- 2%. Por mungon çmimi refuzohet tenderi pamar parasysh vleren.

Nëse Operatori Ekonomik ofron çmimin “0.00” në një nga pozicionet, tenderi duhet të refuzohet ngase në “Përshkrimin e çmimeve” kërkohet të vendoset çmimi në vlerë të caktuar për secilin artkuill/pozicion të kërkuar në specifikimin teknik.

Nëse Operatori Ekonomik plotëson në një nga pozicionet si: “gratis”, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme.

Ndersa per sa i perket kerkeses se ekspertit te prokurimit te angazhuar nga OSHP-ja, dhe vet panelit shqyrtues qe AK te kerkoi sqarime per pozicionin 3.1.12(pozicioni kaldaja –nenstacioni), ne nuk e kemi te qarte se ku e ka te bazuar sipas Ligjit te Prokurimit dhe udhezuesit Operativ qe te kerkohet sqarim ne lidhje me mos plotesimin e një pozicioni(mungon qmimi). Prandaj edhe ne si AK kerkojm nga keto institucionet qe te jene te qarta dhe te na kerkojne sakt se cili nen i Ligjit ose nene i Udhezuesit operative parashev qe te kerkojme sqarime shtese per mungese te çmimit ne një pozicion. Per ne si AK eshte e pa kuptimt dhe jo e ligjeshme kerkesa per sqarim.

Ndersa per sa i perket pretendimit tuaj se ne kemi shpreblyer Operatorin Ekonomik te pa pergjegjeshem edhe kjo nuk qendron pasi qe Eksperti i Prokurimit dhe paneli shqyrtues i OSHP-se kane kerkuar qe ne si AK te konstatojme: se OE i cili eshte rekomanduar per kontrate a ploteson kerkesen tek kapaciteti teknik dhe profesional” Minimumi i mesatares se fuqise punetore dhe stafit menagjerial per sejcilin nga tri vitet e fundit,ndersa deshmi eshte kerkuar” Deklerate apo



**REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE
DRAGASH - DRAGAŠ
ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU**

raport per fuqin mesatare punetore dhe numrin mesatar te personelit udheheqes te OE per sejcilin ne tri vitet e fundit”, ne mendojme se ky kriter eshte plotesuar dhe eshte i qarte ku njejtë eshte konstatuar edhe nga ana e Ekspertit te prokurimit te angazhuar nga vet OSHP-ja me raportin me nr, 595/20 te dates 10.09.2020.Ne mendimin e ekspertit shqyrtues thuhet shume qarte, po citojme “ Duke u bazuar ne sqarimet e lartepermendura,eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE ankues te aprovohet si pjesrisht e bazuar, ndersa vendimi per dhenje te kontrates te mbetet ne fuqi”mbyllt citati.Prandaj nga ky konstatim edhe ne po quditemi se si eksperti i Prokurimit qe eshte angazhuar nga vet OSHP-ja bjer ndesh me vendimin e vet te dates 10.09.2020, ndersa se fundmi kerkon nga AK te kerkoj sqarim. Megjithë ate AK ka kerkuar sqarime nga OE i rekomanduar per kontrate(EBK) me date 28.12.2020 i eshte derguar leter standarde per sqarime ku i eshte kerkuar: “ Ne ndertimi i objektit te qendres se Mjeksise familjare ne fshatin Krusheve(projekt dy vjeqar), edhe pse per ne si AK eshte e qarte, obligohemi qe te ju kerkojme si OE te na deshmoni,te na sqaroni ne lidhje me kerkesen tone ne FDT tek kapaciteti Teknik dhe profesional, ku kerkohet si deshmi: Deklerate apo Raport per fuqin mesatare punetore dhe numrin mesatar te personelit udheheqes te OE per sejcilin nga tri vitet e fundit.

Pergjigjia e OE ne kerkesen tone eshte kthyer me date 28.12.2020, ku thuhet “ Ne oferten qe kemi dorezuar ne E-prokurim per tenderin “ Ndertimi i objektit te qendres se Mjeksise familjare ne fshatin Krusheve(projekt dy vjeqar), duke u bazuar ne kerkesen tuaj si AK,te kapaciteti teknik dhe profesional te kerkesa me nr, 3-minimumi i mesatares se fuqise punetore dhe stafit menagjerial per sejcilin ne tri vitet e fundit,si deshmi eshte kerkuar-Deklerate apo Raport per fuqin mesatare punetore dhe numrin mesatar te personelit udheheqes te OE per sejcilin ne tri vitet e shkuara. Ne dosjen e derguar permes E-prokurimit ne si OE i kemi sjellur listat e punetoreve te cilet jane te DEKLARUAR NE ATK si punetore te rregullt te kompanise per tri vitet e kaluara, te cilet angazhohen ne te gjitha punet e kompanise tone, si dhe e kemi dorezuar një deklarate apo raport te nenshkuar dhe vulosur nga kompanija jone ne formen LISTA E PUNETOREVE AKTIV ne te cilin behet edhe me e qarte fuqia mesatare punetore dhe numri mesatar i personelit udheheqes te kompanise.Keto dy dokumenta paraqesin ne menyre te sakt dhe te qarte per gjigjien ne kerkesen tuaj te cilin edhe ju si AK e keni vlersuar sakte me rastin e vlersimit te tenderit thuhet ne per gjigjien e OE ne letren standarde per sqarime.Besojme se me kete konstatim te AK edhe Paneli Shqyrtues e kane te qarte se pretendimet e OE ankues nuk qendrojne, pasi qe me pare Eksperti i Prokurimit me reportin e tij te dates 10.09.2020. e kishte vlersuar shume drejte dhe ne menyre shume profesionale kete konstatim tonin.

Per sa i perket pretendimit tjeter nga ana e juaj se OE i rekomanduar per kontrate ka patur shkeputje ne vazhdimin e validitetit te sigurimit per dy-tri dite, dhe se eshte i pa per gjegjeshem ne konstatojme se eshte e vertet qe ka patur një shkeputje por ajo eshte bere per shkaqe teknike dhe



**REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES - SKUPŠTINA OPŠTINE
DRAGASH - DRAGAŠ
ZYRA PËR PROKURIM – KANCELARIJA ZA JAVNU NABAVKU**

personale(probleme familjare) dhe se nuk kemi mundur qe ne te njejten kohe t'u dergojme te gjithe OE konkurues kerkesen per vazhdim, por e njejtë eshte bere me vonese prej tre ditesh por ne te njejten kohe jane njoftuar te gjithe OE konkurues dhe se vlersimi eshte bere pas vazhdimit te validitetit, normalisht te gjithe ata qe kane qene te interesuar per me vazhdue e kane bere ate.

Gjithë ashtu sipas Ligjit te Prokurimit dhe Udhezuesit Operativ nuk parashihet askund dhe nuk mund te shpallet i pa pergjegjeshem një OE që ka shkeputje nga vazhdimi i valeditetit por vetem permendet që nje gje e tille te behet para skadimit te afatit. Nese Eksperti I prokurimit apo Paneli shqyrtues na rekomandon se sipas Ligjit apo Udhezuesit Operativ shkeputja e valeditetit te sigurimit te tenderi nenkupton edhe shpalljen e ati OE si te pa pergjegjeshem ne te na thot se cili nen ne Ligj dhe rregullore e parasheh. Me sa dime ne, nese nje gje me Ligj dhe rregullore nuk parashihet se si te veprohet atehere si mund edhe te ndalohet apo te shpallet e pa pergjegjeshme.

Ne nuk kemi asnjeherë OE që e favorizojm ose mbeshtesim siq pretendoni ju, per ne te gjithe jane te pranueshem dhe gjithemon do te shperblehen kushdo qofshin ata qe i plotesojne kriteret e kerkuara sipas LPP.

Sa i perket pra konstatimeve tuaja se ne prap nuk po respektojm vendimet e OSHP-se,ju themi se ne prap mbetemi te njejit dhe nuk ndikohemi,shantazhohemi dhe nuk marim vendime nën presion, ta pa bazur ne ligj vetem se deshironi ju, qe do te thote se ne gjitmone i rrespekojme vendimet e OSHP-se pa marre parasysh se qfare vendimi nxjerr (Rivleresim,Anulim....)

Prandaj ne fund vendoiset si ne dispozitiv te ketij vendimi.

Keshilla juridike: Pala e pa kenaqur sipas nenit 109 te ketij Ligji,mund te ankohet ne Organin Shyrtues te Prokurimit Publik te Kosoves ne afat prej 10 ditesh,nga marrja e ketij vendimi .

Dragash06.04.2021

zyrtari per gjegjes per prokurim


Nuro Ismaili